

INSIG SHA , Shoqëri Sigurimi me eksperiencë mbi 30 vjeçare në industrinë e sigurimeve shpall 1(një) vend të lirë pune për:

Vlerësues Dëmsh pranë Departamentit te Vlerësimit të dëmeve me vendodhje në Tiranë

Kriteret qe aplikantët duhet të plotësojnë janë:

. Te jetë i licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare si "Vlerësues i dëmeve materiale (motorike e pronës)dhe shendetësore"me vlefshmëri deri ne vitin 2026.

.Vendbanimi Tiranë

. Mosha deri ne 40 vjeç

Punonjësi do të kryejë këto detyra:

- Regjistron në Programin e Edusoft të gjitha praktikat e dëmeve materiale TPL, shëndetësore TPL, Kufitare dhe Kasko, brenda ditës së hapjes së praktikës;
- Kryen ekspertizat e mjeteve të dëmtuara si në rastet kur mjeti paraqitet pranë ambienteve të Departamentit të Vlerësimit të Dëmeve ashtu edhe në vendndodhjen e mjetit apo objektit të dëmtuar;
- Bën hedhjen e fotove të mjeteve që u është kryer ekspertiza, sipas datës dhe targës së mjetit;
- Shqyrton dokumentacionin e praktikës së dhënë për vlerësim dhe trajtim dhe harton shkresat drejtuar palës së dëmtuar për plotësimin e dokumentacionit ose vënien e mjetit në dispozicion për kryerje ekspertize;
- Verifikon mbulimin në sigurim të mjetit shkaktar sipas datës së aksidentit dhe të personave të siguruar;
- Shqyrton rregullsinë e Procesverbalit të konstatimit të shkeljes ose të vendimit të prokurorisë apo gjykatës lidhur me ngjarjen dhe në raste të pasaktësive apo të metave përgatit shkresën përkatëse;
- Përgatit brenda afatit 3 ditor shkresën për plotësim dokumentacioni;
- Verifikon dokumentacionin e praktikës dhe gjykon nëse është rast sigurimi ose jo;
- Në rast të dyshimeve të arsyeshme kërkon me e-mail nga drejtori i Departamentit investigimin e ngjarjes;
- Kërkon me e-mail konfirmimin e kryerjes së pagesës së primit për praktikat Kasko si dhe fotot e marrjes në sigurim;
- Dërgon me e-mail tek mjeket e kompanisë, dokumentacionin përkatës shëndetësor, për përcaktimin e masës së paaftësisë;
- Përgatit Autorizimin për rastet e vlerësimit të mjeteve të kategorizuara në grupin e I/a;
- Me miratimin paraprak të drejtorit të Departamentit përgatit Autorizimin për mjetet që do riparohen në servis sipas formularit përkatës dhe e paraqet për nënshkrim tek titullari i Departamentit. Kërkon nga pala e dëmtuar të nënshkruaj marrjen e autorizimit, i jep atij kopjen e Autorizimit për t'a paraqitur pranë servisit si dhe administron Autorizimin origjinal në dosjen e praktikës së dëmit. Kërkon plotësimin e dosjes me Procesverbalet e

dorëzimit dhe marrjes së mjetit nga servisi dhe me Deklaratën e pranimit të mjetit pas riparimit dhe faturën përkatëse;

- Përcakton për çdo rast rezervën e praktikave dhe bën përditësimin e saj sipas ecurisë së trajtimit;
- Kryen vlerësimin e praktikave harton Relacionin e praktikave;
- Nënshkruan çdo dokument të përgatitur apo gjeneruar gjate procesit të vlerësimit dhe trajtimit të praktikës;
- Përgjigjet për respektimin e afateve të trajtimit të praktikave;
- Përgatit në tre kopje Vendimin e Komisionit të Miratimit të Dëmeve me vlere të barabarte ose mbi 200'000 lekë;
- Përgatit Miratimin e vlerës për dëmshpërblim, për të gjitha praktikat e trajtuara me vlere nën 200'000 lekë;
- Përgatit shkresën e Refuzimit të Kërkesës për Dëmshpërblim dhe Vendimin e Komisionit kur vlere e dëmit është objekt i punës së tij;
- Ben inventarizimin e dokumenteve të dosjes dhe e paraqet për miratim tek drejtori i Departamentit;
- Është anëtar i Komisionit të vlerësimit të dëmeve kur mjete i dëmtuar është paleverdi riparimi ose nuk garantohet siguria e tij pas riparimit;
- Është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë procesit të trajtimit dhe vlerësimit të dosjes deri në plotësimin e Deklaratës së pranimit të vlerës së dëmshpërblimit ose të Deklaratës së riparimit të mjetit në servis;
- I jep palës së dëmtuar, me gojë ose me shkrim, sqarimet dhe argumentimet e duhura për rastet kur nuk janë dakord me vlerën e miratuar të dëmshpërblimit;
- Kryen çdo detyre tjetër të dhënë nga Drejtori i Departamentit.

Të gjithë të interesuarit të dërgojnë CV e aplikimit në adresën email: mhasanaj@insig.com.al